



**Engineering progress  
Enhancing lives**

## **Përjetoni ndriçimin e ri.**

SYNEGO SLIDE: Sistemi veçanërisht inteligjent i dyerve dhe dritareve me rrëshqitje për një lidhje tërheqëse me ambientin brenda dhe jashtë.

Dimensioni i ri i dritareve. Për jetën e sotme.



**REHAU**

# Teknologjia e re na e bën jetën më të lehtë. Pse të mos na e bëjë edhe për dyert me rrëshqitje?

REHAU i ka vendosur vetes qëllimin për të zhvilluar dritare dhe dyer që janë po aq moderne sa edhe jetët tona. Kjo gjë e bën jetën tonë më të lehtë dhe më të këndshme.

Më në fund, kemi dyer me rrëshqitje që mund të hapen dhe mbyllen me pak përpjekje dhe me lëvizje të thjeshta të duarve. Besoni tek SYNEGO SLIDE - dhe shijoni lehtësinë e re të rrëshqitjes.





Dimensioni i ri i dritareve.  
Për jetën e sotme.

# Lidhja e hijshme midis ambientit brenda dhe jashtë


Zbuloni mundësitë moderne arkitekture dhe konceptet inovative të dhomës. Dritaret dhe dyert me rrëshqitje nga sistemi me profile SYNEGO SLIDE do t'ju lënë pa fjalë.

**Madhësia maksimale  
4 m x 2,6 m**



## **Më shumë hapësirë për ambientin ku jetoni**

Kur planifikoni ambientin e banesës suaj, pavarësisht nëse është ndërtesë e re apo rinovim - tanimë mund të krijoni më shumë hapësirë dhe të zbatoni koncepte moderne të jetesës. Dritaret me rrëshqitje mundësojnë hapje që kursejnë hapësirë dhe një lidhje të këndshme ndërmjet ambientit të jashtëm dhe të brendshëm. Sigurisht, kjo mundësohet përmes lëvizjeve të lehta dhe bindëse që ofrojnë produktet e familjes SYNEGO SLIDE.



### Pamje e përkryer rreth e rrotull

Zgjidhjet e dizajnit plotësohen me palosjet totale të kasave të laminuara, për një pamje uniforme të dritareve dhe dyerve tuaja.



### Mbi 400 mundësi dizajni

Programi KALEIDO COLOR ju ofron një gamë të madhe variante ngjyrash dhe sipërfaqesh. Në këtë mënyrë, mund të dizajnoni fasadën dhe ambientin ku jetoni tërësisht sipas ideve tuaja të dizajnit.



## Shijoni ndriçim e ri.

Do ta dashuroni mekanizmin novator të mbylljes -  
i lehtë dhe pa shumë përpjekje, madje edhe me  
elementë të tjerë.

### Mbyllet pothuajse vetë

Mekanizmi novator i mbylljes së SYNEGO SLIDE është shumë i lehtë dhe i shpejtë. Ai mundëson një funksionim tërësisht të ri, veçanërisht të lehtë dhe miqësor me përdoruesit e dyerve dhe dritareve me rrëshqitje. Hapja dhe mbyllja kryhet pothuajse vetë dhe kërkon përpjekje minimale.



1

Elementi i rrëshqitjes mund të mbyllet pa shumë përpjekje.



2

Me uljen e dorezës, elementi i rrëshqitjes lëviz lehtësisht në anën e kundërt të kornizës së derës.



3

Nëse doreza është në pozicionin drejt poshtë, dera me rrëshqitje është plotësisht e mbyllur.



### Mbyllet në mënyrë të përkryer

Me mekanizmin e ri të mbylljes, elementi i rrëshqitjes shtyhet në mënyrë të njëtrajtshme në anën e kundërt të kornizës. E kombinuar me papërshkueshmërinë e plotë, kjo krijon një nivel të lartë hidroizolimi - madje edhe ndaj shiut të rrëmbyeshëm.




# SYNEGO SLIDE ofron vlerat më të larta.

Sistemi tërësisht i koordinuar ju ofron komfort jetese në të gjitha dimensionet.

## Ngrohtësi e rehatshme

Dritaret e vjetra janë pika më e dobët energjetike e shtëpisë. Ato janë të izoluara keq dhe teknikisht u ka ikur shumë koha. Pasoja: Energjia për ngrohje e paguar shtrenjtë humbet përmes dritareve.

Nga ana tjetër, dritaret dhe dyert me rrëshqitje të SYNEGO SLIDE befasojnë me vetitë e tyre të shkëlqyera të izolimit termik. Vlera e izolimit termik  $U_f$  arrin deri në  $1,3 \text{ W}/(\text{m}^2\text{K})$ . Humbja e energjisë nga jashtë minimizohet në mënyrë që nxehtësia të mbetet në dhoma.






### Shtëpi e qetë

Ashtu si në sistemin e profilit themelor të testuar SYNEGO, xhami me cilësi të lartë ndaj zhurmës dhe nxehtësisë mund të përdoret për SYNEGO SLIDE. Kjo jo vetëm që mbështet efikasitetin e energjisë, por gjithashtu siguron që zhurma të mbetet jashtë.

Në këtë mënyrë, sistemi përmirëson cilësinë e jetës duke zvogëluar tingullin deri në 43 decibel. Kjo përkon me një reduktim akustik të zhurmës deri në 20 herë.



### Nivel i lartë i papërshkueshmërisë nga shiu


Mekanizmi novator i mbylljes garanton shpërndarjen në mënyrë të barabartë të presionit të kontaktit në elementin e rrëshqitjes. Kjo lejon që puthitja e gjithanshme të përshtatet në mënyrë të përsosur - për papërshkueshmëri të lartë nga shiu.





# SYNEGO SLIDE – pa më të voglin dyshim

Zgjidhjet inteligjente të REHAU ua nxijnë jetën hajdutëve. Përjetoni ndjesinë e sigurisë me to.



## **Pengoni hajdutët**

Moduli i alarmit REHAU Smart Guard, i cili mund të integrohet brenda kornizës, zbulon hajdutët dhe i pengon ata në mënyrë aktive para se të mund të dëmtohen dritaret. Në rast urgjence, alarmi kryesor aktivizohet përmes radios.


Me lidhje opsionale Smart Home për programe individuale alarmi.

**Mbrojtje  
nga  
vjedhjet**



### Siguri me rezistencë të klasës RC 2

Dritaret me klasë rezistence RC 1 kanë një nivel të ulët mbrojtjeje ndaj vjedhjeve dhe për këtë arsye mund të hapen në një kohë relativisht të shkurtër. Dritaret me klasë më të lartë rezistence marrin më shumë kohë për t'u hapur dhe mbi të gjitha, për ti hapur duhen mjete. Dritaret dhe dyert me rrëshqitje SYNEGO SLIDE arrijnë një klasë rezistence deri në RC 2.



# Koncepte inteligjente për dhomat

SYNEGO SLIDE me variantin e dritareve ju ofron shumë dritë në ambient dhe zgjidhje fleksibël dizajni. Përcaktoni pikat kryesore të dizajnit në ambientin ku jetoni në një mënyrë që kursen hapësirë, të këndshme dhe elegante.

## Liri në dizajnimin e brendshëm

Mobiloni apartamentin si të dëshironi, pa qenë nevoja të mendoni për elementet e kornizave që hapen në dhomë.



**Dizajni ambientin ku jetoni në mënyrë të përsosur**

Vendosini mobiliet sipas shijeve tuaja. Lërinë lulet në parvaz kur hapni dritaren. Shijoni fleksibilitetin dhe përdoren hapësirën që gjendet përpara dritareve si të dëshironi. Këto liri tërësisht të reja në dizajnimin e ambientit ku jetoni ofrohen nga varianti i dritareve të SYNEGO SLIDE. Kjo mundësohet nga krahët e profileve të dritareve, të cilat hapen paralel në mur dhe nuk zgjaten përpara në dhomë.





## Qëndrueshmëri maksimale aktive

Si një sipërmarrje aktive në nivel global, REHAU mban një përgjegjësi të veçantë për njerëzit dhe mjedisin. Në këtë mënyrë, ne optimizojmë vazhdimisht përdorimin e burimeve tona dhe efikasitetin e energjisë në fabrikat dhe produktet tona. Profilet e dritareve REHAU me etiketën e produktit EcoPuls tashmë përmbajnë 40% deri në 75% materiale të riciklueshme dhe përfaqësojnë një gjurmë pozitive ekologjike.

**REHAU**  
**EcoPuls**


Sustainability  
Competence

### Materialë plastike të riciklueshme

Kështu, dritaret e vjetra kthehen sërish me sisteme dritaresh të reja dhe të qëndrueshme, me cilësi të njëjtë si dritaret REHAU të përbëra nga materiali i parë. Materiali pastrohet, copëtohet, ndahet dhe rafinohet. Riciklimi që rezulton në fund ripërdoret në strukturën e brendshme të profileve të dritares së re.

Vetëm kjo bën të mundur që REHAU të reduktojë deri në 97 000 tonë CO<sub>2</sub> në vit. Kjo përkthehet në kursimin e rreth 7,8 milionë pemëve në një sipërfaqe afërsisht sa 137 000 fusha futbollli.

Në REHAU, ne kujdesemi vetë për të gjithë procesin e riciklimit - në tregun e dritareve kjo gjë është unike.



### Qëndrueshmëri e shkëlqyer

Të gjitha dritaret evropiane REHAU janë të certifikuara me konfirmimin VinylPlus për prodhimin e dritareve të qëndrueshme. Gjetja, përpunimi dhe riciklimi i lëndëve të para: Këto lëndë të para plotësojnë kriteret e ndryshme dhe të nevojshme përgjatë gjithë zinxhirit të vlerësimit.





# Familja e sistemit SYNEGO

Një Portofol i koordinuar në mënyrë të përkryer që përmbush të gjitha dëshirat tuaja.

## SYNEGO SLIDE

### Të dhëna teknike

Gjerësia e kornizës/profililit ballor:	65 mm/101 mm
Trashësia e kornizës/profililit ballor:	156 mm/80 mm
Izolimi termik $U_f$ (EN 12412-2):	deri në 1,3 W/(m <sup>2</sup> K)
Izolimi i zhurmës $R_w$ (ISO 10140-2):	deri në 43 dB
Rezistenca ndaj vjedhjeve (EN 1627):	deri në Klasën RC 2
Rezistenca ndaj erës (EN 12210):	deri në Klasën B3
Papërshkueshmëria ndaj shiut me erë (EN 12208):	deri në Klasën 8A
Përshkueshmëria e ajrit (EN 12207):	deri në Klasën 4







**Mundësi  
të reja  
arkitekture**

### Dyer për dritare, ballkone dhe oborre SYNEGO

#### Të dhëna teknike

Gjerësia e kornizës/ profilit ballor:	109 mm deri në 175 mm
Thellësia:	80 mm
Izolimi termik $U_f$ (EN 12412-2):	deri në 0,94 W/(m <sup>2</sup> K)
Izolimi i zhurmës $R_w$ (ISO 10140-2):	deri në 47 dB
Rezistenca ndaj vjedhjeve (EN 1627):	deri në Klasën RC 3
Rezistenca ndaj erës (EN 12210):	deri në Klasën B5
Papërshkueshmëria ndaj shiut me erë (EN 12208):	deri në Klasën 9A
Përshkueshmëria e ajrit (EN 12207):	deri në Klasën 4
Forcat operative (EN 13115):	Lloji 2

### Dyer të jashtme SYNEGO

#### Të dhëna teknike

Gjerësia e kornizës/ profilit ballor:	174 mm
Thellësia:	80 mm
Izolimi termik $U_f$ (EN 12412-2):	1,2 W/(m <sup>2</sup> K)
Izolimi i zhurmës $R_w$ (ISO 10140-2):	deri në 45 dB
Rezistenca ndaj vjedhjeve (EN 1627):	deri në Klasën RC 2
Rezistenca ndaj erës (EN 12210):	deri në Klasën B2
Papërshkueshmëria ndaj shiut me erë (EN 12208):	deri në Klasën 4A
Përshkueshmëria e ajrit (EN 12207):	deri në Klasën 2







**Mbështetuni në  
komfortin e ri të jetesës**

**Dimensioni i ri i dritareve.  
Për jetën e sotme.**

Jemi të lumtur t'ju sugjerojmë SYNEGO SLIDE:

Rezervohet e drejta për ndryshime teknike.

Ju lutemi, vini re se informacionet përkatëse teknike të produktit mund të gjenden në internet në faqen [www.rehau.com/ti](http://www.rehau.com/ti).

Për më shumë informacion vizitoni [www.rehau.al](http://www.rehau.al)

© REHAU Representative Office  
Zyra e përfaqësisë REHAU Prishtina  
Eqrem Çabej 13  
10000 Prishtinë  
Republika e Kosovës

© REHAU Representative Office  
Zyra e përfaqësisë REHAU Tirana  
Autostrada Tiranë – Durrës Km 1

[www.rehau.al](http://www.rehau.al)

716831-001 AL 03.2021